ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **651-26-9662-5-2-1**
(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për: **Ndërtimi i Monumentit për Martirët e Luftës 99 Fshati Zhegër Ri-Tender**
(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Al Group SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Ulpiane
(Adresa)

Prishtinë **10000**
(Vendi) *(Kodi postar)*

04945 2222
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Gezim Sylaj
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

shpk.algroup@gmail.com
(Adresa elektronike)

25.11.2026
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.
Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për kontrate i datës **05.11.2026**
- Data e dorezimit te tenderit sipas njoftimit per kontrate **25.11.2026**
- Kerkesa per rishqyrtim: **17.11.2026**
- Pergjigjia e kerkeses per rishqyrtim: **23.11.2026**
- Data e dorezimit te tenderit pas kerkeses per rishqyrtim dhe refuzimit: **25.11.2026**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Procedura eshte ende ne fazen tenderuese

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*
A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve
A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.
Zyra e Prokurimit e Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL I GJILANIT**, më datë 05.11.2026, ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin përkatës të prokurimit. Pas analizimit të hollësishëm të kritereve dhe kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, më datë 17.11.2026, kompania jonë ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, duke kundërshtuar disa nga kriteret e vendosura, të cilat konsiderojmë se janë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), veçanërisht në raport me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe konkurrencës së drejtë. Meqenëse Autoriteti Kontraktues ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim, kompania jonë, në cilësinë e palës së interesuar, parashtron këtë Ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), me pretendimin se Autoriteti Kontraktues ka vendosur kritere dhe kërkesa të cilat kufizojnë konkurrencën dhe nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Këto pretendime do të elaborohen në mënyrë të detajuar në vijim të kësaj Ankese, duke iu referuar konkretisht kritereve të kundërshtuara dhe dispozitave ligjore të shkelura, të paraqitura në pikën 7 të kësaj Ankese – **Dispozitat e LPP-së të shkelura nga Autoriteti Kontraktues**. Për më tepër, kundërshtojmë edhe veprimet procedurale të Autoritetit Kontraktues, i cili, pavarësisht parashtrimit të Kërkesës për Rishqyrtim, ka vazhduar me zhvillimin e procedurave të prokurimit pa bërë shtyrjen përkatëse të afatit për dorëzimin e ofertave. Një veprim i tillë ka ndikuar drejtpërdrejt në afatet procedurale dhe në ushtrimin efektiv të së drejtës sonë për mbrojtje juridike, duke krijuar rrethana që mund të cenojnë të drejtën për një shqyrtim efektiv të pretendimeve tona.
Andaj, kërkojmë nga OSHP-ja që të shqyrtojë në mënyrë të pavarur dhe të detajuar pretendimet tona ankimore, të analizojë ligjshmërinë dhe proporcionalitetin e kritereve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues, si dhe të vlerësojë veprimet e ndërmarra gjatë zhvillimit të kësaj procedure të prokurimit, me qëllim të sigurimit të zbatimit të drejtë të dispozitave të LPP-së dhe garantimit të konkurrencës së lirë dhe të barabartë ndërmjet operatorëve ekonomikë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Neni 1 i LPP: Qëllimi
- Neni 7 i LPP: Barazia në trajtim jo diskriminimi
- Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Neni 60 i LPP: Kriteret për Dhënien e Kontratës
- Neni 65 i LPP: Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve
- Neni 66 i LPP: Përshtatshmëria Profesionale
- Neni 69 i LPP: Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Neni 63 Rregullore 001/2022 (Versioni i Konsoliduar) për prokurimin publik
- Neni 64 Rregullore 001/2022 (Versioni i Konsoliduar) për prokurimin publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të pa kënaqur me njoftimin per kontratë të dates 05.11.2026 ne afatin ligjor konform ligjit, ushtrojmë këtë:

A N K E S Ë

Për shkak se AK- KUVENDI KOMUNAL- GJILAN

1. Në mënyrë te kundërligjshme ka parashtruar kërkesa kritere diskriminuese të vlerësimit të vendosura ne Njoftim për kontrate (NJK) dhe në Dosje te Tenderit (DT.)

SHKEJA 1- Pas parashtrimit të Kërkesës për Rishqyrtim nga ana jonë, Autoriteti Kontraktues, pas nxjerrjes së vendimit për refuzimin e saj, ka vazhduar procedurën e tenderimit, duke mos respektuar detyrimet ligjore që rrjedhin nga neni 109 i Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Konkretisht, Autoriteti Kontraktues ka vazhduar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, pa respektuar afatin ligjor prej dhjetë (10) ditësh, i cili duhet t'i mundësohet Operatorit Ekonomik për ushtrimin e të drejtës së ankesës pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).
Me këtë veprim, Autoriteti Kontraktues ka cenuar të drejtën tonë ligjore për mbrojtje juridike dhe ka vepruar në kundërshtim me parimet e transparencës, ligjshmërisë dhe trajtimit të barabartë, duke mos siguruar respektimin e procedurave dhe afateve të përcaktuara me LPP. Si rrjedhojë, kërkojmë nga OSHP-ja që këtë veprim ta trajtojë si shkelje procedurale dhe të marrë masat përkatëse ligjore, me qëllim të rikthimit të ligjshmërisë në procedurën e prokurimit.

SHKEJA 2- Autoriteti Kontraktues, përmes Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim, mirëpo vendimi i marrë është në kundërshtim me dispozitat e nenit 62.3 të Rregullores për Prokurimin Publik. Konkretisht, neni 62.3 përcakton qartë se: "Vendimi mbi refuzimin do të arsyetohet dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit."
Në rastin konkret, megjithëse Autoriteti Kontraktues ka publikuar përgjigjen për refuzimin e kërkesës sonë, kjo përgjigje është e karakterit të përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës, pa trajtuar dhe pa dhënë arsyetim konkret për pretendimet e ngritura nga ana jonë.
Pra, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë përgjigje të individualizuar për secilin pretendim, nuk ka paraqitur argumente ligjore dhe faktike që do të arsyetonin refuzimin e tyre dhe, rrjedhimisht, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për arsyetimin e vendimit.

Në kuadër të dosjes së tenderit më saktësisht në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2Kërkesa 8. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.Në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar një listë të gjerë të mekanizimit dhe pajisjeve të detyrueshme, të cilat OE duhet t'i posedojnë ose t'i sigurojnë për realizimin e kontratës. Pas analizimit të detajuar të kërkesave të përcaktuara në Aneksin 7, si dhe krahasimit të tyre me natyrën, vëllimin dhe pozicionet e punëve të parapara në Paramasë dhe Parallogari, konsiderojmë se një pjesë e konsiderueshme e këtyre kërkesave nuk kanë ndërlidhje të drejtpërdrejtë me punët që do të realizohen në kuadër të projektit.Përcaktimi i pajisjeve të specializuara, i kapaciteteve të caktuara bartëse, i peshave specifike dhe i konfigurimeve të veçanta teknike, pa dëshmuar domosdoshmërinë e tyre për realizimin e kontratës, paraqet kërkesë joproporcionale dhe potencialisht kufizuese të konkurrencës.Në këtë drejtim, theksojmë se kërkesat për kapacitete teknike dhe profesionale duhet të jenë të ndërlidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës, të jenë të domosdoshme dhe proporcionale me punët që kërkohen të realizohen, në përputhje me parimet e Ligjit për Prokurimin Publik, veçanërisht nenet 1, 7 dhe 10, si dhe dispozitat përkatëse që rregullojnë kriteret e përshtatshmërisë dhe kërkesat teknike. Në vijim paraqesim kundërshtimet tona individuale për secilën pajisje:

SHKELJA 3: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale-9.1 & 9.2 Kërkesa 8. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.Pika
7.1. Kamion kiper me peshë maksimale të ngarkesës së lejuar 20–24 ton – 3 copë
Në Paramasën dhe Parallogarinë e projektit nuk janë paraparë punë që arsyetojnë kërkesën për tri kamionë kiper me kapacitet bartës prej 20–24 tonësh secili. Duke analizuar pozicionet e punëve dhe sasitë e parapara, rezulton se transporti i materialeve dhe i sasive të dheut mund të realizohet në mënyrë të plotë edhe përmes kamionëve me kapacitet më të vogël bartës, përfshirë kamionët me kapacitet deri në 10 tonë. Rrjedhimisht, përcaktimi i një kapaciteti kaq të lartë dhe i një numri të caktuar të pajisjeve, favorizon operatorët që posedojnë pikërisht këtë kategori të mekanizimit. Kërkojmë që kjo kërkesë të rishikohet dhe të përcaktohet në bazë të nevojave reale të projektit, duke lejuar kapacitete të ndryshme bartëse që mundësojnë realizimin e punëve.

SHKELJA 4: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale-9.1 & 9.2 Kërkesa 8. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.Pika
7.2. Ekskavator me çekan, maksimum 7 ton
Në Paramasën dhe Parallogarinë e projektit nuk janë të parapara pozicione të demolimit të betonit, thyerjes së strukturave ekzistuese apo punëve të tjera që do të kërkonin domosdoshmërisht përdorimin e ekskavatorit të pajisur me çekan hidraulik. Për rrjedhojë, kërkesa për këtë pajisje nuk ka bazë të arsyeshme teknike në raport me punët e kontraktuara. Autoriteti Kontraktues nuk mund të kërkojë pajisje të specializuara pa identifikuar pozicionet konkrete të punëve për të cilat ato janë të nevojshme. Kjo kërkesë duhet të largohet nga Aneksi 7,

pasi nuk dëshmohet domosdoshmëria e saj për realizimin e kontratës.

SHKELJA 6: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale-9.1 & 9.2 Kërkesa 8. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.Pika

7.3. Buldozer 12–16 ton – 1 copë

Në analizimin e Paramasës dhe Parallogarisë nuk identifikohet ndonjë pozicion pune që kërkon përdorimin e buldozerit me peshë 12–16 ton. Nuk janë të parapara punë të tilla të rënda të nivelimit, shtyrjes së sasive të mëdha të dheut apo sistemimit të terrenit që do ta arsyetonin domosdoshmërinë e kësaj pajisjeje. Për këtë arsye, kërkesa për buldozer të kësaj kategorie është e panevojshme dhe joproporcionale me objektin e kontratës. Kërkojmë që kjo kërkesë të largohet ose të riformulohet në përputhje me nevojat reale të projektit.

SHKELJA 7: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale-9.1 & 9.2 Kërkesa 8. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.Pika

7.4. Buldozer me lopatë, maksimum 3 ton – 1 copë

Edhe për këtë pajisje, në Paramasën dhe Parallogarinë nuk janë identifikuar pozicione konkrete të punëve që kërkojnë përdorimin e saj. Përcaktimi i dy kategorive të ndryshme të buldozerëve, pa një arsyetim të qartë teknik dhe pa ndërlidhje me pozicionet e kontratës, paraqet kërkesë të panevojshme për mekanizim shtesë.Autoriteti Kontraktues duhet të dëshmojë se për cilin pozicion konkret të Paramasës kërkohet kjo pajisje dhe përse pajisjet e tjera të mekanizimit nuk mund ta realizojnë atë punë.

SHKELJA 8: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale-9.1 & 9.2 Kërkesa 8. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.Pika

7.5. Rul ngjeshës me xhemba, me lopatë rrafshuese, me peshë 3–5 ton – 1 copë

Në Paramasën dhe Parallogarinë e projektit nuk janë të specifikuara punë që kërkojnë përdorimin e rulit ngjeshës me xhemba dhe lopatë rrafshuese në konfigurimin e kërkuar. Për më tepër, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar edhe pajisje të tjera për ngjeshje, si cilindri me xhemba, cilindri gomë-gomë dhe cilindri hekur-hekur. Kjo tregon një mbivendosje të konsiderueshme të kërkesave për pajisje me funksione të ngjashme, pa u dëshmuar nevoja reale për secilën prej tyre. Gjithashtu, përcaktimi i peshës së pajisjes në një interval shumë të ngushtë prej 3–5 tonësh, së bashku me kërkesën për konfigurim të caktuar, kufizon pa nevojë numrin e pajisjeve që mund të pranohen. Specifikimet duhet të orientohen drejt funksionit dhe kapacitetit të nevojshëm, duke lejuar alternativa teknike ekuivalente dhe jo të kufizohen në konfigurime të veçanta pa arsyetim teknik.

SHKELJA 9: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale-9.1 & 9.2 Kërkesa 8. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.Pika

7.6. Cilindër me xhemba me telekomandë, deri në 1 ton – 1 copë

Kërkesa për cilindër me xhemba me telekomandë është e specifikuar në mënyrë të panevojshme kufizuese, pasi funksioni i ngjeshjes mund të realizohet edhe përmes cilindrave me xhemba që nuk janë të pajisur me sistem telekomandimi. Në Paramasën dhe Parallogarinë nuk janë identifikuar punë që kërkojnë domosdoshmërisht përdorimin e një pajisjeje me telekomandë, telekomanda nuk paraqet nevojen direkte per punen dhe funksionalizimin e projektit. Për më tepër, përcaktimi i peshës maksimale deri në 1 ton, së bashku me kërkesën për telekomandë, përjashton pajisje të tjera funksionalisht ekuivalente, të cilat mund të kryejnë të njëjtin funksion. Kërkojmë që kjo kërkesë të riformulohet duke lejuar cilindër me xhemba me, pa telekomandë dhe pa kufizime të panevojshme teknike.

SHKELJA 10: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale-9.1 & 9.2 Kërkesa 8. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.Pika

7.7. Rrethojë montuese për sigurimin e punishtes, minimum 350 metra

Në Paramasën dhe Parallogarinë nuk është përcaktuar ndonjë pozicion i veçantë për furnizimin, montimin apo vendosjen e rrethojave montuese në gjatësi prej 350 metrash. Siguria e punishtes është obligim i operatorit ekonomik gjatë realizimit të kontratës, mirëpo kjo nuk nënkupton se Autoriteti Kontraktues mund të përcaktojë paraprakisht një sasi fikse prej 350 metrash si kusht të detyrueshëm të kapacitetit teknik, pa e arsyetuar këtë sasi me kushtet konkrete të projektit. Përcaktimi i kësaj sasie pa një analizë të nevojave reale të punishtes krijon barrë të panevojshme për operatorët ekonomikë dhe kufizon konkurrencën. Kërkojmë që kjo kërkesë të largohet si kriter i detyrueshëm ose të përcaktohet në bazë të nevojave reale të sigurisë së punishtes.

SHKELJA 11: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale-9.1 & 9.2 Kërkesa 8. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.Pika

7.8. Sharrë hidraulike që montohet në ekskavator – 1 copë

Në Paramasën dhe Parallogarinë nuk janë të parapara pozicione të prerjes së betonit, asfaltit, strukturave metalike, drunjve apo materialeve të tjera që do të kërkonin përdorimin e sharrës hidraulike të montuar në ekskavator. Për rrjedhojë, nuk ekziston ndonjë ndërlidhje konkrete ndërmjet kësaj pajisjeje dhe punëve që duhet të realizohen në kuadër të kontratës. Kërkesa për një pajisje të specializuar, pa pasur pozicion përkatës pune që e arsyeton përdorimin e saj, është joproporcionale dhe duhet të largohet nga Aneksi 7.

SHKELJA 12: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale-9.1 & 9.2 Kërkesa 8. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.Pika

7.9. Kompresor gjysmërimorkio që tërhiqet për thyerjen e betonit – 1 copë

Në Paramasën dhe Parallogarinë nuk janë të parapara punë të demolimit apo thyerjes së betonit që do të kërkonin përdorimin e kompresorit gjysmërimorkio me pajisjet përkatëse për thyerje. Përcaktimi i kësaj pajisjeje si kriter i detyrueshëm për pjesëmarrje në tender nuk ka arsyetim teknik, pasi nuk lidhet me ndonjë pozicion konkret të punëve të parapara. Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të largojë këtë kërkesë ose të identifikojë pozicionet konkrete të Paramasës që e bëjnë të domosdoshëm përdorimin e saj.

SHKELJA 13: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale-9.1 & 9.2 Kërkesa 8. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.Pika

7.10. Kamion kiper me kran dhe platformë (kosh teleskopik 15 metra), me peshë bartëse deri në 7 ton – 1 copë Kjo kërkesë përmban disa funksione dhe karakteristika të ndryshme të kombinuara në një pajisje të vetme, përkatësisht kamion kiper, kran dhe platformë me kosh teleskopik me lartësi 15 metra.Në Paramasën dhe Parallogarinë nuk janë identifikuar pozicione konkrete që kërkojnë domosdoshmërisht përdorimin e kësaj pajisjeje të kombinuar. Edhe në rastet kur paraqitet nevoja për transport, ngritje të materialeve apo punë në lartësi, këto funksione mund të realizohen përmes pajisjeve të veçanta dhe alternativave teknike ekuivalente. Për më tepër, kombinimi i tri funksioneve në një automjet të vetëm, me përcaktimin e lartësisë së saktë të koshit dhe kapacitetit bartës, krijon kufizim të panevojshëm të konkurrencës dhe favorizon një kategori shumë të ngushtë të pajisjeve. Kërkojmë që kjo kërkesë të rishikohet dhe të lejohen pajisje të veçanta ose ekuivalente, sipas nevojës reale të projektit.

SHKELJA 14: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale-9.1 & 9.2 Kërkesa 8. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.Pika

7.11. Ekskavator me strukturë rrotulluese, i pajisur me sistem për nivelim digjital, 3.5–6 ton –1 copë

Kërkesa për ekskavator me sistem të nivelimit digjital, përveçse nuk është e arsyetuar në raport me pozicionet konkrete të Paramasës dhe Parallogarisë, përcakton edhe një konfigurim shumë specifik teknik të pajisjes. Nivelimi dhe realizimi i punëve të terrenit mund të kryhen përmes metodave dhe pajisjeve të ndryshme teknike, pa qenë e domosdoshme që ekskavatori të jetë i pajisur pikërisht me sistem të integruar të nivelimit digjital. Autoriteti Kontraktues nuk ka identifikuar ndonjë pozicion konkret që kërkon këtë teknologji, as nuk ka arsyetuar se përse metodat e tjera të nivelimit nuk janë të mjaftueshme. Për këtë arsye, kërkesa është tepër specifike, joproporcionale dhe kufizuese për operatorët ekonomikë që posedojnë ekskavatorë funksionalisht të përshtatshëm, por pa këtë sistem shtesë.

SHKELJA 15: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale-9.1 & 9.2 Kërkesa 8. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.Pika

7.12. Cilindër gomë-gomë, maksimum 3 ton – 1 copë

Në Paramasën dhe Parallogarinë nuk janë të identifikuara punë që kërkojnë përdorimin e cilindrit gomë-gomë në kapacitetin e specifikuar.Në veçanti, nuk është arsyetuar nevoja për ngjeshje të sipërfaqeve në atë mënyrë që do ta bënte të domosdoshme këtë kategori të veçantë të mekanizimit. Për më tepër, kjo kërkesë vjen krahas kërkesave të tjera për pajisje ngjeshëse, si rul me xhemba dhe cilindra të tjerë, duke krijuar mbivendosje të pajisjeve me funksione të ngjashme. Përcaktimi i një peshe maksimale prej 3 tonësh pa arsyetim teknik kufizon gjithashtu alternativat e mundshme të mekanizimit. Kërkojmë që kjo pajisje të largohet ose kërkesa të riformulohet në mënyrë proporcionale me punët e kontratës.

SHKELJA 16: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale-9.1 & 9.2 Kërkesa 8. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.Pika

7.13. Automikser vetëngarkues për përzierjen e betonit, maksimum 3 ton – 1 copë

Në Paramasën dhe Parallogarinë janë të parapara punë të betonimit të strukturave, mureve mbrojtëse dhe shkallëve. Megjithatë, kërkesa për automikser vetëngarkues me peshë maksimale prej vetëm 3 tonësh nuk është e arsyetuar teknikisht në raport me natyrën dhe vëllimin e punëve të betonimit. Furnizimi dhe transportimi i betonit mund të realizohet përmes automikserëve standardë, të cilët kanë kapacitete dhe konfigurime të ndryshme teknike dhe janë të përshtatshëm për realizimin e këtyre punëve. Nuk ekziston ndonjë arsye teknike që betonimi i strukturave dhe mureve mbrojtëse të kushtëzohet me posedimin e një automikseri vetëngarkues me peshë maksimale 3 tonë.Kjo kërkesë jo vetëm që nuk është e lidhur me nevojën reale të punëve, por edhe kufizon operatorët ekonomikë që posedojnë automikserë standardë me kapacitet më të madh dhe që mund ta realizojnë të njëjtin funksion në mënyrë më efikase. Kërkojmë që kjo kërkesë të ndryshohet duke lejuar automikserë standardë ose pajisje të tjera ekuivalente për furnizimin dhe transportimin e betonit.

SHKELJA 17: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale-9.1 & 9.2 Kërkesa 8. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.Pika

7.14. Minibager me goma për hapjen e kanaleve, në mënyrë të shpejtë zingjirore, 3–5 ton – 1 copë

Kërkesa për minibager me goma, duke e lidhur njëkohësisht me një konfigurim të caktuar për hapjen e kanaleve, është e paqartë dhe kufizuese.Pajisjet e këtij funksioni prodhohen në konfigurime të ndryshme, përfshirë pajisjet me goma dhe ato me zinxhirë (shina). Të dyja konfigurimet mund të realizojnë punë të ngjashme të hapjes së kanaleve, varësisht nga kushtet e terrenit dhe karakteristikat e punës. Nuk ekziston ndonjë arsyetim teknik që të kërkohet ekskluzivisht konfigurimi me goma, duke përjashtuar pajisjet me zinxhirë, të cilat mund të jenë po aq funksionale dhe madje më të përshtatshme në kushte të caktuara të terrenit.Gjithashtu, nëse kërkohet pajisje për hapjen e kanaleve, kriteri duhet të përcaktojë funksionin dhe kapacitetin e nevojshëm, duke lejuar të gjitha konfigurimet teknike që mundësojnë realizimin e punëve. Kërkojmë që kërkesa të ndryshohet dhe të lejohet minibager me goma ose me zinxhirë, me kapacitet të përshtatshëm për realizimin e punëve.

SHKELJA 18: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale-9.1 & 9.2 Kërkesa 8. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.Pika

7.15. Cilindër hekur-hekur, maksimum 1.5 ton – 1 copë

Në Paramasën dhe Parallogarinë nuk janë të identifikuara pozicione konkrete të punëve që kërkojnë përdorimin e cilindrit hekur-hekur me peshë maksimale 1.5 ton. Në veçanti, nuk është arsyetuar nevoja për ngjeshje të sipërfaqeve me këtë kategori të veçantë të mekanizimit. Kjo kërkesë është edhe më e paarsyetuar kur merret parasysh se në të njëjtin aneks janë kërkuar edhe disa pajisje të tjera për ngjeshje, duke krijuar një listë të mbingarkuar me mekanizim të ngjashëm dhe me funksione të mbivendosura. Përcaktimi i një peshe maksimale të tillë, pa ndërlidhje me kërkesat teknike të projektit, përjashton pajisje të tjera që mund të kryejnë të njëjtin funksion. Kërkojmë që kjo kërkesë të riformulohet në bazë të nevojave reale të projektit.

SHKELJA 19: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale-9.1 & 9.2 Kërkesa 8. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.Pika

7.16. Gjysmërimorkio kiper me peshë bartëse 5–8 ton – 1 copë

Për këtë pajisje, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar një konfigurim specifik, përkatësisht gjysmërimorkio kiper me kapacitet bartës 5–8 ton.Megjithatë, funksioni i transportit dhe bartjes së materialeve mund të realizohet edhe përmes rimorkiove të tjera me konfigurime të ndryshme teknike, të cilat mundësojnë të njëjtin rezultat. Nuk ekziston ndonjë arsyetim teknik që të kërkohet ekskluzivisht gjysmërimorkio kiper, duke përjashtuar rimorkiot e tjera me kapacitet të përshtatshëm bartës. Për më tepër, në të njëjtin aneks janë kërkuar edhe kamionë kiper në disa kategori të ndryshme të kapacitetit bartës, duke krijuar mbivendosje të pajisjeve për transportimin e materialeve. Kërkojmë që kërkesa të riformulohet në mënyrë funksionale, duke lejuar rimorkio ose pajisje të tjera ekuivalente për transportimin e materialeve, pa kushtëzuar operatorët ekonomikë me një konfigurim të vetëm teknik.

SHKELJA 20: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale-9.1 & 9.2 Kërkesa 8. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.Pika

7.17. Ngarkues me lopatë dhe fshesë për pastrim, deri në 3 ton – 1 copë Kjo kërkesë është veçanërisht problematike për shkak të kombinimit të dy funksioneve të ndryshme në një pajisje të vetme, përkatësisht ngarkimit me lopatë dhe pastrimit përmes fshesës mekanike. Ngarkuesit me lopatë dhe pajisjet me fshesë mekanike janë pajisje që mund të kenë funksione dhe konfigurime të ndryshme teknike. Nuk ekziston ndonjë domosdoshmëri që këto dy funksione të jenë të integruara në të njëjtën makineri, përveç nëse kjo kërkohet dhe arsyetohet konkretisht nga natyra e punëve. Përcaktimi i një pajisjeje që duhet t'i përmbajë njëkohësisht të dyja funksionet, duke shtuar edhe kufizimin e peshës maksimale deri në 3 ton, e ngushton në mënyrë të panevojshme tregun e pajisjeve që mund të pranohen. Kjo kërkesë përjashton operatorët ekonomikë që posedojnë ngarkues me lopatë dhe pajisje të veçanta për pastrim, edhe pse të dyja mund t'i kryejnë funksionet përkatëse në mënyrë të pavarur dhe me efikasitet të njëjtë. Autoriteti Kontraktues duhet të lejojë realizimin e këtyre funksioneve përmes pajisjeve të veçanta ose përmes pajisjeve ekuivalente, pa kushtëzuar posedimin e një makinerie të vetme me konfigurim të kombinuar.

Me këtë veprim AK ka bere shkelje te nenit 1 te LPP-së ku thuhet se: vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. Paragrafi 1 i nenit 7-të LPP-së e parasheh qartas qe Autoriteti Kontraktues do ti trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
Duke u bazuar në dëshmitë dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga ana juaj si OSHP që të merr:

V E N D I M

- **APROVOHET** si e bazuar ankesa
- **URDHËROHET:** Autoriteti Kontraktues që të bëjë ndryshimin dhe përmirësimin e kërkesave të kundërshtuara në këtë ankesë, duke i harmonizuar ato me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik dhe legjislacionit sekondar në fuqi, në mënyrë që kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit të jenë objektive, të arsyeshme, proporcionale me natyrën dhe qëllimin e kontratës dhe të mos përmbajnë kritere diskriminuese apo kufizuese të konkurrencës.

  Gjithashtu, URDHËROHET që pas eliminimit të kritereve diskriminuese dhe përmirësimit të dokumentacionit të tenderit, Autoriteti Kontraktues të sigurojë mundësi të barabarta për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar, duke respektuar parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së drejtë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Pa anashkaluar demet materiale, më shumë dëm po i bëhët konkurrences së ndershme dhe të drejtë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"*
   ****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*